



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 7285
Data: 04.09.2025

PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR ME SEKTORIN E ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË PËR DRAFT BUXHETIN PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2027-2028

Procesverbali nga Dëgjimi i parë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028, të mbajtur me datën **14.08.2025**, duke filluar nga ora **11:00** në **Sallën e Takimeve**, e cila gjendet në katin e I-rë në objektin e Komunës, me gjithsej 20 pjesëmarrës/e, prej tyre 7 gra dhe 13 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Mehmet Ballazhi**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**, si dhe nga Zyra e Kryetarit dhe disa nga drejtorët/et e drejtorive.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z.Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve, të cilët kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2026, si dhe parashikimi për vitet 2027-2028, ku për rend të punës, kishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**
2. **Diskutimi**

Mehmet Ballazhi thekson: Po vazhdojmë edhe sot mbajtjen e dëgjimeve buxhetore për draft buxhetin e vitit 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028, ku sot jemi me sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, ku keni mundësinë që në veçanti të jepni porpozimet dhe rekomantimet tuaja për orientimin e buxhetit. Përpara jush gjeni materialin, ku janë të shënuara tyë dhënat mbi ndarjet buxhetore, por edhe projektet kapitale, por kjo s'do të thotë që s'mundet me pas edhe projekte tjera jashtë këtyre, sepse sot çdo porpozim i juaji do të shënohet, shqyrtohet dhe do të avzhdohet më pas për miratim. Për vitin 2026 buxheti do të jetë rreth 4.2 milion euro, rreth 60% do të jetë për paga dhe mëditje, pastaj për investime kapitale, subvencione dhe transfere, mallëra dhe shërbime, etj. Prioritetet e mia për 4 vitet e kaluara kanë qenë arsimid he shëndetësia, e poashtu do të vazhdojnë të jenë prioritete edhe për 4 vitet e ardhshme. Jemi mundu që orientimin e buxhetit me e pas të barabartë për nga rëndësia, gjithëpërfshirja gjeografike, gjithëpërfshirja gjinore, dhe për fusha të ndryshme. Për më detajisht, drejtoresha do ta bëjë prezentimin e buxhetit.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor, i cili këtë radhë i dedikohet sektorit të arsimit dhe shëndetësisë.)

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti në disponim për vitin 2026 është 4,234,682 €, prej tyre e dedikuar për investime kapitale është shuma 891,140 €, pra këtë shumë ne mund ta shpenzojmë për projekte të ndryshme kapitale, ku para vetes keni fletushkat e përgatitura nga Instituti GAP, të cilën janë të listuara projektet kapitale, ku ka projekte që barten vit pas viti, por edhe projekte tjera të propozuara nga qytetarët. DO të isha dnalë tek Grandi Specifik i Arsimit, ku për vitin 2026 ka një rritje prej vitit aktual, ku ky grand do të përbëhet prej 34% të buxhetit total, ndërsa tek sektori i shëndetësisë kemi disa risi në krahasim me vitin aktual: kemi 13 pozita të reja të aprovuara në sektorin e shëndetësisë, ku 4 prej këtyre pozitave janë të specifikuara, pra ka të bëjë me një fizioterapeut, punëtor social, logoped dhe psikolog, kurse pjesa tjetër e stafit mund të rekrutohet në bazë të nevojave sipas mundësive buxhetore të sektorit të shëndetësisë. Nëse keni ndonjë propozim, ne jemi të hapur për t'i dëgjuar dhe më pas këto do të dërgohen për diskutim dhe shqyrtim me grupin punues për hartimin e draft buxhetit.

2. Diskutimi

Mehmet Ballazhi Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit. Nëse keni ndonjë sugjerim, rekomandim, kërkesë për buxhetin e vitit 2026.

Basri Dernjani: Si planifikime duken mjaft mirë duke u bazu te materiali që kemi, por nëse do të ishte mundësia me i dhanë rëndësi internetit të shkolla se tash veç jemi me tabela digjitale, si dhe kisha kërku që mësimdhënësit me u pajisë me laptopa, e tash ne duhet me përgatit material edhe me powerpoint për prezantime. Si dhe me shqyrtu mundësinë që së pakunë Han të Elezit me u apliku mësimi gjithditor.

Ahmet Krasniqi: Sa e pash në material, 50 mijë € janë të dname në arsim si dhe 40 mijë euro për subvencione. Shkolla jonë është pajisë me 5 tabela smart, do të ishte mirë që të gjitha klasët me u pajis me tabela smart. Edhe kanë nevojë disa mësimdhënësit me u pajisë me laptopa. Te testi i arritshmërisë po kemi probleme, dhe te nxënësit po e kanë problem kur po i ndajnë profesionet, me mutj me iu bo fletushka ose materiale që i orientojnë për shkollim ma tutje.

Mehmet Ballazhi: Prioritet e kemi pas digjitalizimine shkollave dhe me u bo model në Kosovë në këtë drejtim, por kjo s'do të thotë se do të ndalemi këtu, projekti për digjitalizim të shkollave do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Si për tabela digjitale, e si për furnizim me laptopa, varet nga buxheti, por do ta shqyrtojmë mundësinë. Kurse te pjesa e vetëdijësimit mbi orientimin e profesioneve, normalisht në takimet që do t'i keni bashkë ju si drejtori, duhet të merrni propozimet dhe të hartoni materiale që iu ofrohen nxënësve.

Fitim Thaçi: Lidhur me digjitalizimin e shkollave, do të ishte mirë me u ofru trajnime për mësimdhënësit se si me u përdorë tabela digjitale, si dhe me u shqyrtu mundësia që edhe testimet me u bo online, ku do të kurseheshin fletat e bardha. Poashtu do të ishte mirë që me kompaninë e telefonisë, ku kemi 2€, por afatin e kanë shumë të shkurtër, e do të ishte mirë që me u vazhdu afati. Poashtu te mbikalimi te rr.Martirët Bushi, a parshihet vendkalimi vetëm për vetura apo edhe për këmbësorë?

Mehmet Ballazhi: Aty parashihet që mbikalimi të jetë për vetura, ku kemi pas planifikim me e nis si projekt gjatë këtij mandati, por siç jeni në dijeni, kontratat kolektive na kanë penalizu, dhe për shkak të mungesës së mjeteve, as nuk kemi mundur me i udhëheqë si procedura. Pra, ne kemi futur projekte që me i pas si kode buxhetore, edhe mbikalimiet, edhe shkollën në Lagje të Re, edhe tjera projekte, por për shkak të buxhetit nuk kemi mund me bo planifikime më të mëdha buxhetore, por me figuru si kode buxhetore, kuse për trajnime për përdorim të tabelave smart, sa e di janë bërë por edhe do të avzhdojnë në ardhmen me trajnime për të gjithë mësimdhënësit.

Shenasi Dernjani: Unë kisha çështjen e mësimit gjithëditor, si ka me u realizu, ndoshta dueht infrastrukturë, menaxhim, etj.

Hisni Luri: E tha edhe Kryetari, prej prioriteteve ka qenë arsimi dhe shëndetësia. Te arsimi, po e filloj prej bursave, ku nga 30, sot kemi 50 bursa që ndahen për studentë, duke i përfshirë edhe nga ata që studiojnë në Maqedoninë Veriore, poashtu kemi investu edhe në infrastrukturë: hapësira të brendshme të shkollave, hapësira të jashtme sportive. Kemi ndryshu sistemin e nxemjet te çerdhja, nga druri në pompë termike. Në bashkëpunim me MASHT është kompletu salla sportive në SHFMU “Kështjella e Diturisë”, Rreth 75% e klasëve janë të kompletuara me tabela smart si fazë e parë, e tani me mjetet që do të dalin tash, planifikojmë fazën e dytë ku kanë me u pajisë krejt klasat e gjithashtu edhe janë të planifikume edhe trajnimet. Te rregullimi i infrastrukturës shkollore, kemi vendosë vynil në cerdhe, ku ofron ma shumë siguri. Jemi në pritje të lurjes së pjesës së brendshme në SHML “Dardania”. Për vitin tjetër, planifikojmë me e bo dhomën e vlerësimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në SHFMU “Ilaz Thaçi” e cila quhet dhoma blu, e cila momentalisht gjendet te QPS. Në planifikime e kemi edhe ndërtimin e çerdhes dhe shkollës në Lagje të Re, ku edhe do të mund të fillojmë edhe mësimin tërëditor. Jemi në fazën e kompletimit të dy shkollave me panele solare, bashkëinvestim me MASHT, ku janë SHML “Dardania” dhe SHFMU “Veli Ballazhi”. Lidhur me internetin në shkolla, kemi lidh marrëveshje me operatorin, e gjithashtu edhe për furnizim me laptopa, ne kemi një procedurë për furnizim me pajisje të IT, por momentalisht janë për kompjutera që munden me u përdorë në klasa, por në të ardhmen shohim mundësinë me furnizim me laptopa. Ndërsa për orientim në karrierë e kemi një mësuese për këtë fushë, si dhe kemi mbajtë trajnime edhe përmes Project of Kosova lidhur me mënyrën e të menduarit dhe lexuarit, si dhe ne kemi bo një kërkesë tek agjencioni për mbrojtje apo si quhet, për me e zhvendosë matësin e ndotjes së ajrit në fund atje, për shkak se planifikohet me u ndërtu një kënd i lojërave aty përballë.

Habib Thaçi: Është me u vlerësu që jemi ndër komunat me digjitalizim të shkollave ma t’mirë, ku më s’kemi shkumës, por gjithçka e digjitalizume. Lidhur me propozimet, kisha propozu që ne si komunë me e hap një fond të veçantë për nxënësit e talentum si ndihmë financiare, ku do të rritej kureshtja e tyre për me mësu, shembull nëse një nxënës shpalllet ma i miri, prej atij foondi me e shpërbly. Gjithashtu kisha propozu që me u organizu kuzie të diturisë, ku me u paraparë shpërbime, ku besoj se do të nxiteshin nxënësit për mësim, kur do të bëhehin gara edhe mes shkollave. Tjetra më shumë si falënderim, ku pagesat e shutjave për mësimdhënësit janë bërë në kohë dhe kjo ka qenë ndihmesë shumë e madhe për të gjithë mësimdhënësit.

Fitim Thaçi: Ka nxënës që vazhdojnë mësimin edhe në Ferizaj, dhe shpesh detyrohemi që orën e fudnit ndoshta me e lanë shkak që s’ka transport, a është mundësi që këtyre nxënësve me iu ofru transport, sepse sa e di deri në Kaçanik ka, por ka nxënës edhe në Feizaj.

Mehmet Ballazhi: Lidhur me transportin, ne kemi bisedu me operatorë të ndryshëm, por s'kemi mund me gjet hapësirë për shkak se linjat e transportit nuk i caktojmë ne.

Musafer Dibrani: Unë si punëtor te IP Ardhmëria, shoh që janë bo punë shumë të mirë, ku tash mo janë vebdosë pompat termike dhe çështja e nxemjes është krejt tjetër nivel, paoshtu vendosja e vynilit, ku ofrohet ma shumë siguri për të gjithë, si për stafin si për fëmijët, poashtu edhe rregullimi i hapësirave për pushim të fëmijave.

Mehmet Ballazhi: Ideja e ndarjes së drejtorisë së arsimit nga drejtoria për kulturë, rini dhe sport, ka qenë pikërisht sepse duke e ndarë si drejtori, fokusi ka qenë veçmas tek arsimi, ku njëkohësisht edhe tek kultura rinia e sporti, ku njëkohësisht janë zhvilluar të dyja drejtoritë.

Shenasi Dernjani: A e keni parashiku që me u shtu një drejtim i ri në Han të Elezit, qoftë për ujësjellës, elektrikë ose diçka tjetër, që nxënësit që duan orientime tjera veçmas atyre që i kemi, mos me shku në Ferizaj apo vende tjera?

Hisni Luri: Prej dy vitesh, ne po bëjmë përpjekje me pas bashkëpunim me një nga shkollat në Feizaj që me pas s'paku një klasë me drejtim profesional, por është e pamundur me udhëzimin e ri administrativ, që duhet ose gjimnaz ose shkollë profesionale, e ne nuk mundemi që gjimnazim me e kthy në shkollë profesionale.

Mehmet Ballazhi: Përveç arsimit, sektori i shëndetësisë është i njëjti nivel për nga rëndësia, ku siç i listoi drejtoresha, parashihet shtimi i stafit dhe në veçanti sektorë të rëndësishë, si fizioterapia, logopedi, psikolog, por edhe punëtor social, e paoshtu me mundësi rekrutimi edhe staf tjetër sipas nevojave dhe mundësive buxhetore. Presim propozime edhe për sektorin e shëndetësisë.

Bashkim Hazizi: Duke pasur parasysh shtimin e stafit, sa është e mundshme që ky staf me pas hapësirat e veta për veprim, shkak se momentalisht kemi mungesë të hapësirave, ku momentalisht e kemi vetëm një dhomë për mjek, një hapësirë tejte është bërë deponi për barna dhe material shpenzues. Nuk kemi mungesë me barna esenciale, jemi mjaft mirë në këtë pjesë përveç me glukozën që është problem në nivel qendror. Ndërsa tek AMF në Gorançë shërbimet vazhdojnë të jepen në orarin e caktuar, mirëpo ka nevojë për investime në infrastrukturë por edhe inventar, ka nevojë me u rregullu dhe me u ly muret dhe hapësirat tejra, dyshemeja me u rregullu, gjithashtu duhen karrige të përshtatshme, poashtu edhe shtretërit për pacientët, se edhe ashtu ahpësira është pak e ngushtë aty.

Mehmet Ballazhi: Me planin e ri zhvillimor, parashihet ndërtimi i një QKMF në venin ku deri para pak kohe ka qenë e vendosur Policia e Kosovës, dhe aty do të ketë hapësira të mëdha dhe si loacion ne veçse e kemi aktualisht aty, mirëpo me buxhetin komunal është e pamundur me u ndërtu shkak se vetëm ajo kërkon 2-3 milion euro, dhe ne shohim mundësitë përmes organizatave të mëdha, si me Qatar-in apo edhe me organizata tjera që ne veçse do të orientojmë kërkesa. Lidhur em kërkesa tjera, në fushën e shëndetësisë, kompania sharrcem na ak ndihmu ajshtëzakonisht shumë, si em shërbimet e kardiologut momentalisht gjatë këtij viti, poashtu për stomatolog deri sa e mundësum si pozitë të rregulltë, e poashtu edhe shërbime tjera. Pra, deri sa të gjendet një donator për ndërtimin e një QKMF të re tek ai loacion, do të duhet që me u koordinu që edhe ato pozita me funksionu rrebenda hapësirave aktuale në QKMF.


Shenasi Dernjani: Për me i ndërlidh shërbimet mjekësore me shkollat, do të ishte mirë që në fillim të vitit shkollor me u mundësu kontrole mjekësore për nxënësit, e di që ka pas, por me u shpeshtu.

Bashkim Hazizi: Bashkë me DSHMS ne kemi organizu aktivitete të tilla, por sipas diskutimeve, ne mundemi me organizue dhe tjera sipas nevojave.

Mehmet Ballazhi: Ne do t'i marrim të gjitha rekomandimet tuaja, do t'i shënojmë dhe do t'i shqyrtojmë. A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

